



KOMUNA - MITROVICË

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës

Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



KONTRATË – PUNË

TITULLI I KONTRATËS

Mirëmbajtja dhe pastrimi i lumenjve Trepça dhe Lushta në Mitrovicë

Bashkëfinancim me MMPH.

(Memorandum Mirëkuptimi me MMPH)

Nr¹ i prokurimit	642-19-6213-5-1-1
Nr i brendshëm	642/19/0028/511

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATË PUNË.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate është ekzekutimi i punëve në çmimet e ofruara për njësi dhe në total dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve si në vijim nga ana e Kontraktuesit:

Mirëmbajtja dhe pastrimi i lumejve Trepça dhe Lushta në Mitrovicë- Bashkëfinancim me MMPH.(Memorandum Mirëkuptimi me MMPH).

KOMUNA- MITROVICË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik EURONDERTIMI SH.P.K.; Infra-Plus SH.P.K., Rr. Azem Behrami, 40000, Mitrovicë (në vazhdim "Kontraktori"), me nr Biznesi: **810108995** në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë për Punët e cekura si në vijim:

Mirëmbajtja dhe pastrimi i lumejve Trepça dhe Lushta në Mitrovicë- Bashkëfinancim me MMPH.(Memorandum Mirëkuptimi me MMPH).

me numër identifikues: Nr i Prokurimit: **642-19-6213-5-1-1**; Nr i brendshëm: **642/19/028/511**

Autoriteti kontraktues kryen punë vetëm në emër të vet Komuna e Mitrovicës

Përdorimi i kësaj kontrate është i detyrueshëm për të gjithë Autoritetin Kontraktues të Komunën e Mitrovicës të specifikuar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit]

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **[30/10/2019]** dhe përfundon me **[29/10/2021]**.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **[820.000,00] €**; **[Tetëqindë e njëzetëmijë euro e 00/100] Euro.**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve. Pagesat do të bëhen brenda periudhës 2 (dy) vjeqare 24 mujë sipas alokimit të mjeteve dhe nga Komuna si vijon dhe Minisytia e Infrastrukturës:

Kontrata është 2 (24 mujë) vjeqare dhe do paguhet sipas alokimit të mjeteve nga MMPH sipas dinasmikës në vijim.

Vitin 2019 – 220.000,00 vitet tjera sipas alokimit të mjeteve nga MMPH.

(Pagesat e cekura mundë të ndryshojnë varsishtë nga alokimet e mjeteve nga Komuna dhe MMPH brenda viteve të cekura).

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria
- (f) Identifikimi financiar i O.E.(pjesë e DT).

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për punët e vendosura nën këtë kontratë publike për punë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën [SHQIPE]³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Një(1) Original për Njësën kërkuese

Një(1) Original për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa


Një(1) Original për Drejtorinë e Prokurimit dhe

Një(1) Original për Kontraktuesin.

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Për Autoritetin Kontraktues: Komuna- 40000 Mitrovicë	
Emri:	Haxhimet FERATI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	30/10/2019
Vula:	

Ne rast te kontratave me vlere te madhe]

Emri:	Agim BAHTIRI
Pozita:	Kryetar i KOMUNËS -- Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	30/10/2019
Vula:	

Për Kontraktorin: Grup i Operatorëve Ekonomik EURONDERTIMI SH.P.K.; Infra-Plus SH.P.K., Rr. Azem Behrami, 4000, Mitrovica	
Emri:	Fatmir BEHRAMI
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	30/10/2019
Vula:	



PJESA III E KONTRATES **KUSHTET E VEQANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulojnë nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [SHQIPE] .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% të vlerës së Kontratës ose 82.000.00 € me kohëzgjatje prej 25 muajsh.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [N/A]; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [N/A]; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [N/A]; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit:[N/A] (ii) të personave të tjerë: [N/A]
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda [5] ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
Azhurnimi-Periudha e Intervenimit	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është [1] ditë ose 24 orë pas marrjes së shkresës ose një kërkesë nga ana e AK do të jetë efektiv për intervenim për gabimet ose defektet gjatë kryerjes së punëve.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë [01/11/2019]
Përfundimi i punëve	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë [2 vite,ose 24 muaj] ose 29/10/2021.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë [0.05%] për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është [10%] e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	[Specifikoni nëse një regjistër i punës nuk është nevojitet].
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është [.....], nr i tel 049/.....]emajl adresa: [@rks-gov.net].
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: [N/A]

Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: [N/A]
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [5] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 12 muaj [365] ditë nga pranimi teknik i punëve..
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha punët ose të realizojë punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së Punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Qdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të punëve të kësaj kontrate është e mundur të zgjidhet në mënyr miqësore, përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues–Komuna Mitrovicës dhe personat përgjegjës të kontraktorit.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [specifikoni gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].